



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec



Procesverbal i Dëgjimeve për Buxhetin e vitit 2022 dhe Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2022-2024 në Drenoc

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 859 Nr. i faq./Br. str./No. pg 250

Data/Datum/Date 12 / 8 / 21

RAHOVEC / ORAHOVAC

INFORMATË RRETH NJOFTIMEVE

Njoftimi për organizimin e dëgjimeve buxhetore për buxhetin e vitit 2022 dhe KAB-in për vitet 2022-2024, u publikua me datë: 17.06.2021 në ueb faqen e komunës së Rahovecit, në të dy gjuhët, në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2021/06/Kalendari-i-degjimeve-buxhetore-per-Buxhetin-e-vitet-2022-dhe-Korniza-Afatmesme-Buxhetore-KAB-te-Komunes-se-Rahovecit-per-vitet-2022-2024.pdf> dhe <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2021/06/Raspored-Javni-Rasprava-za-Budzet-i-Srednjorocni-Okvir-Budzeta-Opstine-Orahovac-za-2022-2024.pdf> në harmoni me afatet ligjore që i përcakton Udhëzimi Administrativ, si vijon:

Në mbështetje të nenit 68, paragrafi 68.1 i Ligjit Nr.03L-40 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 17 dhe nenit 18 paragrafi 1, pika 1.7, të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005, të datës: 29.03.2017, nenit 6 pika 1.3, i Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publike në Komuna, Rregullores Komunale për Transparencë me Nr. Prot. 2697, njoftojmë se nga data: 06.07.2021 deri me datë: 16.07.2021 nën organizimin e kryesuesit dhe anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) do të organizohen pesëmbëdhjetë (15) dëgjime publike buxhetore me qytetarë, për planifikimin e buxhetit për vitin 2022 dhe KAB-in për vitet 2022-2024.

Me qëllim të rritjes së nivelit të transparencës e llogaridhënies dhe për t'i mbajtur sa më të informuar banorët e komunës së Rahovecit, rreth orarit dhe vendit të mbajtjes së dëgjimeve buxhetore, janë bërë me kohë planifikimet dhe është publikuar me kohë kalendari i dëgjimeve buxhetore për pesëmbëdhjetë (15) dëgjimet buxhetore në vendbanimet e komunës së Rahovecit në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2021/06/Kalendari-i-degjimeve-buxhetore-per-Buxhetin-e-vitet-2022-dhe-Korniza-Afatmesme-Buxhetore-KAB-te-Komunes-se-Rahovecit-per-vitet-2022-2024.pdf> më datë: 17.06.2021.

Poashtu, bazuar në afatet ligjore janë njoftuar me kohë banorët e secilit vendbanim rreth mbajtjes së dëgjimeve me anë të publikimit të secilit njoftim veç e veç, për secilin vendbanim, në ueb faqe të komunës, shtatë ditë para mbajtjes së dëgjimit në atë vendbanim.

Njoftimi për mbajtjen e dëgjimit buxhetor në fshatin Drenoc u publikua më datë: 02.07.2021 në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2021/07/Njoftim-per-degjim-publik-per-buxhetin-e-vitet-2022-dhe-KAB-in-2022-2024-me-banor-te-fshatrave-Drenoc-Pastaselle-Senoc-Zatriq-Kaznik-dhe-Nushpal.pdf>

Njoftimet përveç që janë publikuar në uebfaqe të komunës, në Platformën për Konsultime Publike, në rrjetin social Facebook, njoftimet u janë dërguar edhe kryetarëve të këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane përmes rrjeteve sociale Viber dhe WhatsApp.

DËGJIMI PUBLIK NË DRENOC

Dëgjimi buxhetor me banorë të fshatrave **Drenoc, Senoc, Pastasellë, Kaznik, Zatriq dhe Nushpallë**, u mbajt më **09.07.2021** me fillim në orën: **18:10**, në ambientet e shtëpisë së kulturës “Feim Gashi” në Drenoc.

Zyrtarët pjesëmarrës në këtë dëgjim nga KPF-ja dhe zyrtar komunal ishin: 10

- Femra ishin: 3
- Meshkuj ishin: 7

Qytetarë pjesëmarrës gjithsej të pranishëm ishin: 8

- Femra ishin: 0
- Meshkuj ishin: 8

Dëshmi janë listat nënshkruese të pjesëmarrësve në këtë dëgjim.

Dëgjimim e shpalli të hapur kryesuesi i Kuvendit Komunal, z. Afrim Dina.

Afrim Dina: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, të nderuar kryetar të fshatrave Drenoc, Senoc, Pastasellë, Kaznik, Zatriq dhe Nushpallë, ju të pranishëm. Faleminderit që sot jeni këtu.

Jemi sot këtu ne dëgjimet buxhetore, për të marrë kërkesat tuaja si banorë, prioritetet që ju keni dhe më pas t'i harmonizojmë në planifikimin që bëhet për vitin 2022.

Buxheti për vitin 2022 do të jetë 15,053,660.00 Euro, kurse Investimet Kapitale kapin vlerën 4,815,786.00 Euro. Ju lus që kërkesat edhe pasi t'i paraqisni këtu, me shkrim dhe të protokoluara si sjellni dhe në Komunë, që më pas të cëdohen nëpër drejtoritë përkatëse. Nëse ka dikush nga kolegët e KPF-së mund të bashkangjiteni, nëse jo urdhëroni ju përfaqësues të fshatrave.

Xhemajl Kastrati, kryetar i këshillit të fshatit Drenoc: Të nderuar anëtarë të KPF-së, i nderuar kryesues, ju të pranishëm! Faleminderit për pjesëmarrje dhe mirë se erdhët në Drenoc!

Kërkesat e fshatit **Drenoc** janë:

- Ndërtimi i kanalizimit 20%
- Ndërtimi i trotuareve
- Kubëzimi i rrugicave
- Hapja e rrugëve fushore
- Ndërtimi i fushës së futbollit
- Asfaltimi i rrugës kryesore me shtresën e dytë të asfaltit
- Rregullimi i shkollës
- Mbujllja e drunjve dekorativ

Daut Krasniqi, Kryetar i këshillit të fshatit Senoc: Përshëndeti të pranishmit, përshëndeti punën e ekzekutivit, njëherësh shprehu shqetësimin e tij për mungesën e ujit të pijes në fshat dhe paraqiti kërkesat e tij si përfaqësues i fshatit Senoc.

Kërkesat e fshatit **Senoc** janë:

- Furnizimi me ujë të pijes,
- Kubëzimi i rrugëve,
- Rregullimi i ndriçimit publik,
- Rregullimi i rrugëve fushore,
- Rregullimi i kanalizimit krijimi i hapësirave gjelbëruese (parqe), dhe
- Ndërtimi i trotuarit në rrugën kryesore.

Jeton Krasniqi, kryetar i këshillit të fshatit *Pastasellë*, ka paraqitur kërkesa të cilat së bashku me kryesinë e fshatit I kanë cilësuar si më të nevojshme.

Kërkesat e fshatit **Pastasellë** janë:

- Kubëzimi i rrugëve,
- Rregullimi i ndriçimit publik,
- Vazhdimi i kanalizimit,
- Rregullimi i trotuarit në rrugën kryesore,
- Rregullimi i një parku,
- Rregullimi i një rruge fushore,
- Mirëmbajtja e një rruge fushore,
- Largimi i mbeturinave në dy lokacione,
- Mbjellja e drunjve dekorativ.

Dëgjimi buxhetor përfundoi në orën: 18:45

Blerta Gashi

*Zyrtare përgjegjëse për koordinimin e dëgjimeve,
konsultimeve dhe takimeve publike*

Rahovec,